

BASHKIA KAVAJË
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

1. Autoriteti Qiradhënës: Bashkia Kavajë

Adresa: Rruga "Josif Budo", Ndërtesa Nr. 10,

Email: www.kadastra.bashkiakavaje@gmail.com

Tel: 055245555

2. Të dhënat për sipërfaqen: Sipërfaqja prej 1010 m² e pasurisë nr. 302/3, lloji pasurisë truall, pasuri e cila është në pronësi të Bashkisë Kavajë, regjistruar në ASHK-në Kavajë në vol. 3 faqe 205 ZK. 2291, me vendodhje në Kryemedhenj.

3. Qëllimi i dhënies me qira: Pasuria objekt i dhënies me qira do të jepet në zbatim të nenit 54/1 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe do të meren parasysh të gjitha kërkesat e Ligjit nr 93/2015 "Për turizmin", kryesisht në fushën e turizmit për qëllime rekreative, pushimi etj, e cila do të gjenerojë të ardhura dhe do të nxisë punësimin.

4. Afati i dhenies me qira: 20 (njëzet) vjet, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

5. Vlera dysheme për detyrimin e qirase: 1 212 000 (një milion e dyqind e dymbëdhjetë mijë) lekë në një vit kalendarik.

6. Konkurimi për marrjen me qira do të kryhet në ambientet e Bashkisë Kavajë në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak me datë 26.01.2024 në orën 11:00

7. Vlerësimi i ofertave të konkurentëve do të bëhet me pikët si më poshtë:

Niveli i investimit 40 pikë

Niveli i punësimit 30 pikë

Oferta e detyrimit mujor të qirasë 30 pikë

8. Subjektet konkurrese duhet të përcjellin dokumentacionin si më poshtë:

- kërkesën e subjektit së bashku me gjeneralitetet, vendbanimin, pikën e kontaktit, për marrje me qira të pasurisë shtetërore, ku në të të deklarohet qëllimi i marrjes në përdorimit të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurrimit të parashikuar sipas planit të biznesit;
- planbiznes të hollësishëm për përmirësimin e pronës, i cili duhet të përmbajë siglën dhe vulën e administratorit të shoqërisë, në çdo faqe të tij.
- përshkrimin e projektideve të investimit ku të përshkruhet qartë plani i punësimit, plani i investimit si dhe treguesit që do të realizohen;
- ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qirasë
- Deklaratat në formën e vetëdeklarimit ku të përfsihet informacioni i mëposhtëm:

- Deklaratë mbi NIPT/NUIS të subjektit kërkues

- Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore

- Deklaratë mbi administratorin dhe subjektin juridik ofertues nëse është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin

- Në rast se subjekti konkruues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë në objekte pronë shtetërore, të deklarojë shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore.

Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme përbën kusht skualifikues.

9. Dokumentacion duhet të paraqitet në zarf të mbyllur, të nënshkruar nga konkruuesi me mbishkrimin “Ofertë për marrje me qira“, dhe i dorëzohen komisionit të shqyrtimit të ofertave, në orën e hapjes së procedurës së konkurrimit.

10. Ofertat dorëzohen nga konkurenti/ët e interesuar, fizikisht me postë ose dorazi në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurrimit.

11. Data e zhvillimit të konkurrimit: në ambientet e Bashkisë Kavajë, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak, me datë 26.01.2024 në orën 11:00

12. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: datë 26.01.2024, ora 11:00